

Simptomat e verdha

Kontaktoni Klinikën e mjekut tuaj familjar, ose thirrni **sot** numrin NHS 111, nëse fëmija juaj ka ndonjë nga këto simptoma, ose nëse besoni që fëmija juaj mund të ketë sëmundje të rëndë, ose nëse diçka ju shqetëson dhe nuk gjendet në këto lista -

Pyesni Thjesht: “Vallë mund të jetë sepsë?”

Temperatura

- Temperatura e ngritur (mbi 37,5°C) për pesë ditë ose më gjatë
- Dridhjet ose lëkundjet

Frymëmarrja

- Flegrat ndryshojnë nga madhësia me çdo frymëmarrje
- Frymëmarrje e zhurmshme ose me ‘rale’
- Kollitja e cila tingëllon si lehja e fokës

Lëkura, Buzët dhe Gjuha

- Lëkura jashtëzakonisht e zbehtë. Në lëkurën me pigment më të errët, mund të jetë më e lehtë të vësh re ndryshime nga ana e brendshme e parakrahut ose nga pëllëmbat
- Tharja e gojës, buzëve dhe/ose gjuhës

Ushqimet dhe Pijet

- Foshnjë e cila nuk ushqehet (pi më pak se gjysmën e sasisë së zakonshme të qumështit)
- Ngrënia shumë më pak se zakonisht
- Ka vjellë më shumë se dy herë gjatë 24 orëve të fundit

Tualeti / Pelenat

- Më shumë se pesë jashtëqitje të ujshme (diareja) gjatë 24 orëve të fundit te foshnjat më të vogla se 1 vjeç
- Vetëm një urinim ose pelenë e lagur brenda tetë orësh

Aktivitetet dhe Trupi

- Më pak interes se zakonisht për lozjen
- Mezi zgjohet ose jashtëzakonisht gjumash
- Ënjtja e një gjymtyre ose nyje
- Mospërdorimi/mosvënia e peshës mbi një krah, këmbë ose dorë



Skanoni kodin QR për më shumë informacione, ose vizitoni abuhb.nhs.wales/sepsis ose sepsistrust.org

Simptomat e kuqe

Shumë (por jo të gjithë) fëmijë me këto simptoma janë seriozisht të sëmurë.

Veproni menjëherë. Thirrni numrin 999, ose shkoni drejt Njesisë së Vlerësimit të Emergjencës së Fëmijëve te The Grange University Hospital.

Temperatura

- Temperatura mbi 38°C te foshnjat më të vogla se tre muajsh
- Temperatura mbi 39°C te foshnjat e grupmoshës tre deri gjashtë muajsh
- Çdo temperaturë e lartë te një fëmijë i cili nuk mund të nxitet të shfaqë interes për asgjë
- Temperatura e ulët (nën 36°C, kontrolloni tri herë brenda një periudhe 10-minutëshe)

Frymëmarrja

- E ka shumë më të vështirë se zakonisht të marrë frymë – duket si punë e rëndë
- Bën zhurma ‘gromërimash’ me çdo frymë që merr (te të porsalindurit kjo mund të tingëllojë si blegërimat e një qengji)
- Frymëmarrja shumë e shpejtë (më shumë se një frymë çdo sekondë te foshnjat)
- Nuk thotë dot më shumë se disa pak fjalë njëherësh (për fëmijët më të mëdhenj të cilët flasin zakonisht)
- Frymëmarrja e cila duket qartë se ‘bën pauzë’

Lëkura, Buzët dhe Gjuha

- Lëkura është kaltroshe, e larme (e purpurt, e kuqe) ose shumë e zbehtë. Te lëkura me pigment më të errët, mund të jetë më e lehtë të zbulosh ndryshime nga ana e brendshme e parakrahëve ose nga pëllëmbat
- Buzët ose gjuha është kaltroshe
- Sytë duken ‘të zgavërt’
- Duart dhe këmbët janë jashtëzakonisht të ftohta kur preken
- Skuqje e cila nuk venitet kur shtypet fort (përdorni një gotë të qartë)

Tualeti / Pelenat


- Ka 12 orë që nuk ka urinuar as lagur pelenën

Ushqimet dhe pijet

- Foshnjë e porsalindur nën moshën një muajshe pa interes për t’u ushqyer
- Nuk pi për më shumë se tetë orë (kur është e zgjuar)
- Tepër e etur
- Nuk mund t’i mbajë poshtë lëngjet
- Vjell herë pas here për më shumë se 24 orë
- Me njollë prej vreri (jeshile), me të vjella të gjakosura ose të zeza

Aktivitetet dhe trupi

- Po fryhet pika e butë e kokës së foshnjës
- Fëmija nuk mund të nxitet të shfaqë interes tek asgjë
- Foshnja është e flashkët
- E dobët, ‘angullin’ ose qan pa ndërprerje, te fëmija më e vogël
- Fëmijë më i madh i cili hutohet
- Nuk reagon, ose shumë nevrík
- Mezi zgjohet, nuk rri dot zgjuar ose nuk duket se ju njeh
- Qafa e paepur, sidomos kur përpiqet të shikojë lart e poshtë



“Para se të sëmurej në Dhjetor 2022, Dylan ishte 9 vjeçar i shëndetshëm me natyrë të dashur, joshëse dhe të ndjeshme. I pëlqente kodimi, zgjidhja e shpejtë e enigmave, si dhe zbulimi i botës me mendje kureshtarë. Tragjikisht, shumë dështime kanë ndodhur kur Dylan u sëmur. Duam që Dylan të përkujtoret si personi unik që ishte. I shtyrë nga dëshira për drejtësinë, Dylan synonte t’i ndreqte të këqijat. Sot jam zëri i tij, dhe punoj për të përmirësuar sigurinë për të tjerët. Nuk ka pse të duhet vdekja e parandalueshme e ndonjë fëmije që të jetojnë të tjerët, por duam edhe që ‘DYLAN’ të përkujtoret si akronim: Përkeqësimi mund të jetë i shpejtë, Fëmijën tuaj e njihni më mirë vetë Ju, Mësoni shenjat dhe simptomat, Veproni shpejt, Kurrë mos i dyshoni instinktët tuaja.”

Mamaja e Dylan-it, Corinne Cope.

Si ta diktosh fëmijën e sëmurë

Çfarë është sepsa?

Sepsa është gjendje mjekësore emergjente ku sistemi imunitar mbireagon ndaj një infeksioni. Ajo mund të prekë çdokënd, dhe pa mjekim urgjent, mund të çojë në dëshimin e organeve dhe vdekjen.

Megjithatë, sepsa shpesh mund të mjekohet nëse zbulohet shpejt, prandaj pyesni gjithmonë: **‘vallë mund të jetë sepsë?’**

